



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY



06-02/2857

13-07-2022

DATË/A:	01.07.2022
REFERENC-Ë:	AKK-DPKI-06-1457/22
PËR/ZA/TO:	z. Zenun ELEZAJ, Kryetar i Komunës së Klinës
CC:	z. Abaz FONIQI Ish-Udhëheqës i Prokurimit në Komunën e Klinës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Yll BULESHKAJ, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Esad EJUPI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit

I nderuari z. Elezaj,

Duke vepruar sipas kërkesës së parashtruar në formë të shkruar nga raportuesit e jashtëm, të cilët kanë paraqitur pretendimet se ish-udhëheqësi i Prokurimit të Komunës së Klinës z. Abaz Foniqi, për më pakë se dy (2) muaj pas përfundimit të funksionit publik (pensionimit) është shpërblyer me kontratën “Shërbime të veçanta-ekspert bashkëpunëtor për prokurim publik”, nga Komuna e Klinës, Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim: Agjencia), konform kompetencave të saj të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), në cilësinë e autoritetit qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.12, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 21, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.4, 1.5, 1.7 dhe paragrafi 2, të Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nxjerrë këtë:

OPINION

I. Shpërblimi me kontratë i ish-zyrtarit të lartë pa kaluar dy vite nga përfundimi i funksionit publik (pensionimit) nga institucioni në të cilin ka qenë i punësuar zyrtari, është në kundërshtim me dispozitën e nenit 18, paragrafi 1 nënparagrafi 1.2. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

II. Agjencia në mbështetje të dispozitave të nenit 21 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8., nenit 22 paragrafi 13, nenit 24 paragrafi 5 dhe 6, lidhur me nenin 19 paragrafi 2, nënparagrafi 2.5. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kërkon anulimin e Kontratës Nr. 107/2021 dhe pasojave të krijuara nga kontrata në fjalë.

Arsyetim

Agjencia kundër Korrupsionit në bazë të raportimeve nga jashtë (DPKI-06-1457/22 dhe DPKI-06-2488/22), ka hapur rasatin për konflikt të interesit, me pretendimet se ish-udhëheqësi i Prokurimit të Komunës së Klinës z. Abaz Foniqi, për më pakë se dy (2) muaj pas përfundimit të funksionit publik (pensionimit) është shpërblyer me kontratën “Shërbime të veçanta-ekspert bashkëpunëtor për prokurim publik”, nga Komuna e Klinës.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve, Agjencia kundër Korrupsionit me shkresë zyrtare e ka njoftuar z. Ali Gashi, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit (i autorizuar deri më datën 09.03.2022) për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, me z. Gashi është organizuar edhe një takim në zyrat e Agjencisë, me ç’rast e ka konfirmuar se pretendimet e ngritura janë të vërteta, porse nuk ka qenë në dijeni se një gjë e tillë është e ndaluar me ligj. Gjithashtu në takimin e mbajtur (20.05.2022), z. Gashi ka deklaruar se do ta njoftojë ZKA-në lidhur me rastin në fjalë dhe se bashkë me të do të ndërmarrim veprime për ta anuluar kontratën në fjalë bashkë me pasojat e krijuar, ndërsa deri në nxjerrjen këtij Opinioni, Agjencia nuk ka marrë ndonjë informacion nga z. Gashi.

Me qëllim të sqarimit të plotë të këtij rasti, Agjencia kundër Korrupsionit ka siguruar dokumentacione/informacionet e nevojshme (DPKI-06-02/2548/22), pas shqyrtimit dhe analizimit të të cilave ka gjetur se:

Sipas kërkesës së Drejtorisë të Administratës e datës 11.10.2021 dhe me aprovimin tuaj si ZKA ishte iniciuar aktiviteti i prokurimit për “*Shërbime të veçanta – ekspert bashkëpunëtor në prokurim publik*”, me numër 634-21-7622-236 i datës 15.10.2021. Pastaj me Vendimin nr. 01 351-37549/21 i datës 18.10.2021 të Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, ishte pezulluar përkohësisht kjo procedurë e prokurimit pasi që ishin paraqitura kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorëve ekonomik të pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues.

Më pas, me Vendimin e Kryetari të Komunës të datës 28.10.2021 ishte formuar Komisioni i Vlerësimit, për vlerësimin e ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit si më lartë. Komisioni i Vlerësimit përmes Raportit të Vlerësimit të Tenderëve të datës 29.10.2021, kishte rekomanduar dhënien e kontratës për z. Abaz Foniqi, ish-udhëheqës i Prokurimit në Komunën e Klinës, i cili raport kishte marrë pëlqimin edhe nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit z. Ali Gashi.

Në bazë të rekomandimit në fjalë, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit z. Ali Gashi, kishte nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues nr. 01-112-39095/21 i datës 01.11.2021, përmes të cilit ishte shpërblyer me kontratë personi fizik z. Abaz Foniqi, dhe atë vetëm tridhjetë e gjashtë ditë (36) pasi që i njëjti kishte përfunduar punësimin si Udhëheqës i Prokurimit në Komunën e Klinës (Zyrtar i Lartë Publik).

Kjo është në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, pasi që në nenin 18 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. të kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike, është përcaktuar se:

1. Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë:

[...] 1.2. të përfshihet në marrëdhënie kontraktore, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndonjë personi të afërm ose të besuar, me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik; [...]"

Andaj, në mënyrë që të evitoni shkeljen e dispozitës ligjore nga neni 18 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, të konstatuar nga Agjencia kundër Korrupsionit, kërkohet nga ju që brenda afatit shtatë (7) ditë nga pranimi i këtij Opinioni, të ndërmerri veprime konkrete, duke anuluar kontratën Nr. 107-2021¹ si dhe obligimin e z. Foniqi që mjetet e fituar në bazë të kësaj kontrate t'i kthehen Komunës së Klinës .

Me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përgjegjësia për ndërmarrjen e masave të nevojshme për të shmangur paraprakisht në çdo rast konfliktin real ose të mundshëm të interesave, bie mbi udhëheqësin e zyrtarit ose institucionin udhëheqës, ashtu siç përcaktohet me nenin 19, paragrafi 2 nënparagrafi 2. 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si në vijim:

"2. Çdo udhëheqës i zyrtarit ose institucion udhëheqës merr masat e nevojshme, të përshkallëzuara dhe proporcionale për të shmangur paraprakisht dhe në çdo rast konfliktin real ose të mundshëm të interesave për shkak të zgjedhjes, emërimit apo caktimit të detyrave ose përgjegjësi të caktuara të zyrtarit. Këto masa përfshijnë por nuk kufizohen:

"[...] 2.5. revokimin ose anulimin e një akti të marrë në kushtet e konfliktit të interesave."

II. Kërkesa e Agjencisë drejtuar Komunës së Klinës për anulimin e Kontratës Nr. 107-2021, është bazuar në dispozitën e nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilën është përcaktuar:

"1. Agjencia kryen detyra dhe ka këto përgjegjësi: [...] 1.8. inicion veprimet ligjore në institucionet kompetente, me qëllim shpalljen e pavlefshmërisë dhe rregullimin e pasojave që rrjedhin prej saj për aktet dhe kontratat administrative të nxjerra në kushtet e konfliktit të interesave, me kërkesën e palëve të interesuara ose me nismën e saj"

si dhe bazuar në nenin 22, paragrafi 13 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se:

"Agjencia i kërkon rishqyrtimin, revokimin dhe/ose shfuqizimin e aktit të nxjerrë në konflikt të interesit organit që e ka nxjerrë atë. Që nga momenti kur Agjencia kërkon rishqyrtimin e vendimit, çdo veprim për zbatimin e tij pezullohet deri në momentin kur organi vendos për vlefshmërinë e vendimit."

¹ Numri i kontratës lidhur me transaksionet me thesarin 634-21-7622-2-3-6.

Pastaj edhe me nenin 24, paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit te përgjegjësit e tjera ligjore dhe pasojat mbi aktet, është përcaktuar se:

5. *Agjencia inicion procedurën administrative për revokimin ose shfuqizimin e akteve nga ana e institucionit që i ka lëshuar ato në konflikt interesi.*

6. *Agjencia inicion procedurën administrative dhe/ose gjyqësore për anulimin e akteve dhe për obligimin e zyrtarit përgjegjës për shlyerjen e pasojave materiale dhe financiare të akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesit.*

Andaj, në mënyrë që të evitohen shkeljet e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konflikti të Interesit, pastaj ruajtjes së integritetit të institucionit të Komunës së Klinës, Agjencia kundër Korrupsionit, rekomandon që:

- Në rastet e ngjashme të shmangen situatat e konfliktit të interesit në burim nga udhëheqësi i institucionit, duke mos lejuar përfitimin/lidhjen e kontratave nga ish-zyrtarët e lartë publik të komunës, pa kaluar dy (2) vite nga përfundimi i marrëdhënies së punës, ashti siç e përcakton nenin 18 i Ligjit për Parandalimin e Konflikti të Interesit.

Agjencia kundër Korrupsionit, kërkon që në afat të arsyeshëm të njoftohet lidhur me veprimet e ndërmarra lidhur me rastin në fjalë, konform nenit 19 paragraf 4, të Ligjit për Parandalimin e Konflikti të Interesit.

Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik ka për qëllim forcimin e integritetit në sektorin publik dhe garantimin e kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik dhe kjo kryesisht nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesit.

Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit.

Agjencia Kundër Korrupsionit ju falënderon për bashkëpunimin.

Me respekt,